



Kolegji AAB

RREGULLORE

**Për procedurën e punimit të temës së diplomës
bachelor**

Prishtinë, Qershor 2024

Në bazë të nenit 20 të Statutit të Kolegjit AAB, Senati në mbledhjen e mbajtur me datën 07.06.2024 miratoi këtë:

RREGULLORE

Për procedurën e punimit të temës së diplomës bachelor

I. Dispozita Të Përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore aplikohet në të gjitha programet e studimit në të cilat tema e diplomës vlerësohet me ECTS dhe kërkohet temë diplome për të përfunduar studimet e nivelit bachelor.

Neni 2

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

1. Të përcaktojë mënyrën e paraqitjes së temës së diplomës;
2. Hartimin e temës së diplomës;
3. Vlerësimin e punimit të diplomës;
4. Procedurën dhe
5. Të përcaktojë rregulla të tjera që kanë të bëjnë me temën e diplomës.

Neni 3

1. Studenti për të diplomuar dhe për t'u pajisur me diplomë të studimeve themelore, është i obliguar që të hartojë dhe mbroj me sukses punimin e diplomës të nivelit Bachelor.
2. Punimi i diplomës bachelor është i detyrueshëm në të gjitha ato programe që janë akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe vlerësohet me ECTS.
3. Në programet e studimit tri vjeçare, studenti duhet që nga provimet dhe punimi i diplomës të akumuloj gjithsej 180 ECTS.
4. Në programet e studimit katër vjeçare, studenti duhet që nga provimet dhe punimi i diplomës të akumulojë gjithsej 240 ECTS.
5. Punimi i diplomës bëhet nga fusha e studimit në programin përkatës studimor.

Neni 4

Punimi i diplomës është punë individuale e studentit i cili duhet të vërtetojë që aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fusha të caktuara.

Neni 5

1. Dekani kërkon nga të gjithë profesorët dorëzimin e një regjistri të temave të cilat mund t'i marrin studentët.

2. Regjistri i temave bëhet publik për studentët vetëm pas miratimit nga Këshilli mësimor i fakultetit.
3. Studentët mund të propozojnë edhe tema tjera që nuk janë në regjistrë të cilat duhet t'i nënshtrohen procedurës së rregullt të vlerësimit dhe aprovimit.

Neni 6

1. Studenti mund ta paraqesë kërkesën për punimin e temës së diplomës nga fillimi i semestrit të fundit.
2. Tema e diplomës paraqitet duke plotësuar formularin-kërkesën (*formulari 1*) i cili duhet të përmbajë: shënimet e studentit, titullin e punimit, lëndën mësimore nga e cila ka zgjedhur temën, emrin e mentorit dhe datën e paraqitjes së temës-kërkesës.
3. Pas aplikimit, Dekani merr vendim për formimin e komisionit për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave deri në mbrojtjen përfundimtare (*vendimi*).
4. Propozimi i temës aprovohet duke plotësuar formularin e veçantë i cili duhet të përmbajë: datën e lejit të temës, titullin e temës, lëndë, komisionin për vlerësim dhe nënshkrimet e komisionit (*formulari 2*).
5. Pas pranimit të versioneve të punimit të diplomës, komisioni obligohet në të gjitha rastet t'i përgjigjet studentit brenda afatit prej 7 ditësh.
6. Nëse komisioni vlerëson pozitivisht punimin, atëherë janë plotësuar kushtet për mbrojtje të punimit të diplomës dhe në bashkëpunim me dekanin caktohet edhe data e mbrojtjes (*formulari 3*).
7. Nëse komisioni vlerëson negativisht punimin e diplomës, atëherë studentit i cakton afat shtesë për plotësim dhe rregullim.
8. Nëse njëri nga anëtarët e komisionit e vlerëson "negativisht", ndërsa dy të tjerët japin vlerësim pozitiv, studentit i plotëson kriteret për të punimit të diplomës.
9. Studenti mundet gjate gjithë kohës të heq dorë nga tema e zgjedhur duke dorëzuar në administratë fletëdorëheqjen dhe të filloj procedurën e zgjedhjes së temës së re nga fillimi.
10. Studenti i plotëson kushtet për mbrojtje e temës pas përfundimit të të gjitha provimeve.
11. Tema e lejuar duhet të mbrohet në afatin prej 6 muajve, pas këtij afati tema anulohet dhe studentit obligohet të zgjedhë temë të re.

Neni 7

1. Kandidati punimin e diplomës duhet ta dorëzojë në dy (2) kopje fizike:
 - 1.1. një kopje në format origjinal (të përgatitur në libër A4) për dosjen e studentit;
 - 1.2. një kopje në format origjinal (të përgatitur në libër A4) për Komisionin;
 - 1.2. një kopje në formatin elektronik (pdf) për bibliotekën elektronike.

Neni 8

1. Mbrojtja e punimit të diplomës bëhet para komisionit, mësimdhënësve, studentëve, kolegëve, familjarëve, miqve dhe të interesuarve tjerë;
2. Kandidati prezanton punimin e diplomës në formën që zgjedhë vetë. Kohëzgjatja e prezantimit është prej 10 deri 20 minuta. Kryetari i komisionit

- pas përfundimit të prezantimit ju jep mundësinë anëtarëve të komisionit të bëjnë pyetje lidhur me punimin e diplomës dhe vetë prezantimin. Pyetje mund të parashtrijë edhe vet kryetari dhe audienca;
3. Çdo anëtarë mund t'i parashtrijë më së shumti 2 pyetje.
 4. Pas përfundimit të prezantimit dhe pyetje/përgjigjeve, komisioni e shqyrton punimin e diplomës, paraqitjen e kandidatit dhe përgjigjet në pyetjet e komisionit si dhe bazë të tyre edhe vlerëson kandidatin me notën përfundimtare.
 5. Notat e punimit të diplomës janë:
 - a. 10 (A) – (SHKËLQYESHËM);
 - b. 9 (B) – (SHUMË MIRË);
 - c. 8 (C) – (MIRË);
 - d. 7 (D) – (KËNAQSHËM);
 - e. 6 (E) – (MJAFTON);
 - f. 5 (F) – (PAMJAFTUESHËM)
 6. Në rast të mungesës të një anëtari të komisionit në mbrojtje të punimit, punimi mund të mbrohet edhe me praninë e dy anëtarëve.

Neni 9

1. Nëse vlerësimi përfundimtar i temës së diplomës është me notë të pamjaftueshme nga ana e komisionit, atëherë komisioni i jep studentit edhe një afat prej 30 ditësh për eliminimin e të metave dhe plotësimin e rekomandimeve të dhëna.
2. Procedura e mbrojtjes publike pas 30 ditësh përsëritet sipas neneve të mësipërme.
3. Nëse edhe pas përsëritjes së mbrojtjes publike, studenti vlerësohet me notën pamjaftueshëm atëherë anulohet tema dhe studenti obligohet të fillojë procedurën nga fillimi duke zgjedhur temë të re.

Neni 10

1. Me rastin e mbrojtjes së punimit të diplomës përpilohet procesverbali mbi provimin e diplomës, i cili përmban këto shënime:
 - a. Numrin rendor dhe datën (numrin e protokollit)
 - b. Emrin dhe mbiemrin e studentit
 - c. Numrin e dosjes
 - d. Datën e regjistrimit të parë
 - e. Statusin e studentit
 - f. Tema e punimit të diplomës
 - g. Anëtarët e komisionit
 - h. Nota në punimin e diplomës
 - i. Vërejtjet eventuale mbi punimin dhe mbrojtjen
 - j. Emrat dhe mbiemrat si dhe nënshkrimet e anëtarëve të komisionit për mbrojtjen e punimit
2. Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe asistenti/ja administrativ i fakultetit.
3. Procesverbali mbi mbrojtjen e punimit të diplomës i dorëzohet administratës ku deponohet dhe ruhet në dosjen e studentit.

Neni 11

1. Studenti, i cili më sukses e mbron punimin e diplomës, fiton thirrjen BAÇELOR për drejtimin përkatës.
2. Studentit, pas përfundimit me sukses të mbrojtjes së punimit të diplomës, i lëshohet certifikata për kryerjen e studimeve themelore 3 apo 4 vjeçare.

Hartimi i punimit të diplomës

Neni 12

1. Punimi i diplomës është pjesë e strukturuar e të shkruarit që zhvillon një linjë të qartë të mendimit në përgjigje të një pyetjeje qendrore ose propozimi.
2. Punimi i diplomës është i ndarë në kapituj dhe përmban një ekzaminim në mënyrë të konsiderueshme më të detajuar për çështjet në fushën e adresuar dhe dëshmi apo evidenca të ndryshme në lidhje me fushën e studimit, gjë që kërkon më shumë punë se në rastin e punimit të një eseje.
3. Me rastin e punimit të diplomës, studentit duhet t'i përmbahet formës dhe përmbajtjes së punimit të përcaktuar më këtë rregullore.
4. Respektimi i formës nënkupton: stilin, gjuhën, drejtshkrimin, faqet e punimit, klasifikimi, radhitja e përmbajtjes, citimi i rregullt.
5. Respektimi i përmbajtjes nënkupton: aplikimin korrekt të metodave, argumentimi i qëndrimeve, konkluzionet dhe rekomandimet etj.
6. Studenti dhe mentori duhet të sigurohen që punimi i diplomës të jetë punë origjinale e studentit dhe jo kopjim i një punimi tjetër. Marrja e punimeve të tjera dhe përvetësimi i tyre konsiderohet plagjiaturë dhe është e ndëshkueshme me rregulloret e institucionit.

Forma e punimit

Neni 13

Punimi i diplomës shkruhet me kompjuter në letër të formatit A4 dhe përbëhet nga:

1. Kopertinat
 - a. Logo
 - b. Emri i Kolegjit
 - c. Emri i fakultetit/programit
 - d. Titulli i temës
 - e. Emri i mentorit dhe emri i kandidatit
 - f. Viti i punimit
2. Fleta e pastër
3. Fleta e brendshme me të dhënat identike si në kopertinë
4. Përmbajtja
5. Hyrja
6. Rishikimi i literaturës
7. Metodologjia
8. Shtjellimi i temës
9. Përfundimet
10. Bibliografia

Neni 14

1. Punimi i diplomës duhet të ketë nga 7000 deri 10 000 fjalë të shkruara nga hyrja deri të përfundimi i punimit.
2. Punimi i diplomës duhet teknikisht të shkruhet sipas këtyre udhëzimeve:
 - a. Punimi i diplomës duhet të shkruhet në MS Word;
 - b. Madhësia e fontit të përdorur duhet të jetë:
 - i. 18 për titullin e punimit të diplomës në faqen e parë
 - ii. 16 për kapitujt
 - iii. 14 për nënkaptujt
 - iv. 12 për tekstin e shkruar
 - c. Modeli i fontit të përdorur duhet të jetë **Times New Roman**
 - d. Hapësira në mes rreshtave duhet të jetë 1.5
 - e. Teksti duhet të jetë **Justified**. Selektu tekstin dhe shtyp në tastatur Ctrl+J
 - f. Margjinat duhet të jenë të njëjta në të gjitha anët. Klikoni në Page Layout dhe zgjidhni **Normal**

Neni 15

1. Të gjithë formularët dhe procedura e administrimit të temës mund të zhvillohet përmes sistemit elektronik të institucionit.
2. Mbrojtja e temës së diplomës mund të bëhet në ambientet e institucionit apo edhe online përmes platformave të ndryshme, ashtu siç vendos komisioni në bashkëpunim me studentin.
3. Dekani mund të caktojë ditë të veçanta për mbrojtje të temave të diplomës.

Neni 16

Për zbatimin e kësaj rregulloreje, do të hartohen udhëzues të veçantë të cilët në detaje do të përcaktojnë formën e punimit, stilin e referencimit dhe çështje tjera më rëndësi.

Neni 17

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit të saj nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori.


Dr.sc. Blerim Olluri, Rektor



Numri i dosjes së studentit

Emri dhe mbiemri i studentit

FLETËPARAQITJE
Për paraqitjen e temës së diplomës

Titulli i punimit:

Lënda mësimore:

Mentori:

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Studenti:

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Vërteton:

Asistenti/ja Administrative:

(emri dhe mbiemri)

Dt. _____



Nr. _____/2024, Prishtinë, ____/____/2024

Në bazë të nenit 49 dhe 81 të Statutit të Kolegjit AAB dhe nenit 6 të Rregullores për procedurën e punimit të temës së diplomës bachelor, Dekani i Fakultetit, merr këtë

VENDIM

I

Formohet Komisioni për aprovimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës të studentit/es: _____

Me titull: _____

II

Për anëtarë të komisionit për aprovimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës caktohen:

1. _____, **kryetar**;
2. _____, **mentor**;
3. _____, **anëtar**.

III

Ky komision ka për detyrë ta shqyrtoj temën e propozuar dhe nëse i plotëson kushtet, ta aprovoj të njëjtën, ose t'i japë rekomandime studentit, pastaj ta vlerësoj punën e studentit, dhe në fund mbrojtja publike e studentit bëhet para këtij komisioni.

Mentori ka për detyrë të përcjell punën e studentit, t'i ofrojë atij ndihmën profesionale gjatë hartimit të punimit të diplomës, ta udhëzojë në literaturën themelore, ta njoftojë me rregullat që parashihen.

III

Pas dorëzimit të punimit, tashmë të lidhur në kopertina, në 3 (tre) ekzemplarë, me propozim të mentorit, caktohet koha e mbrojtjes së tij.

DEKANI

Dërgohet:

1. Anëtarëve të Komisionit
2. Administratës.

Numri i dosjes së studentit

Emri dhe mbiemri i studentit

V E N D I M
Për lejimin e temës së diplomës

Data e lejimit të temës: _____

Titulli i punimit:

Lënda mësimore: _____

Komisioni:

1. _____ kryetar

2. _____ mentor

3. _____ anëtar

Numri i dosjes së studentit

Emri dhe mbiemri i studentit

FORMULAR

Për vlerësimin e punimit të diplomës

Pas pranimit dhe vlerësimit të punimit të diplomës, komisioni në përbërje prej:

1. _____ kryetar
2. _____ mentor
3. _____ anëtar

E vlerëson:

Pozitivisht:

Dhe pas konsultimit me dekanin e fakultetit si datë për mbrojtjen publike të punimit të diplomës caktohet data:

_____, në orën _____

Negativisht:

Rekomandimet e komisionit për plotësimin e temës:

Komisioni:

4. _____ kryetar
5. _____ mentor
6. _____ anëtar

Dt. _____



Nr. _____/2024, Prishtinë, ____/____/2024

PROCESVERBAL I PROVIMIT TË DIPLOMËS

Kandidati: _____ (_____) _____, i lindur më _____ në _____ ka mbrojtur punimin përfundimtar me temën:

“ _____ ”,
para Komisionit për aprovimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës, të cilin e ka formuar Dekani me vendimin Nr. _____ / _____, datë _____, në përbërje:

1. Kryetar: _____;
2. Mentor: _____;
3. Anëtar: _____.

Komisioni në përbërje të plotë vlerësoj punimin e diplomës dhe prezantimin e studentit dhe konstatoj se:

Kandidati ka mbrojtur me sukses temën e diplomës dhe vlerësohet me notë:

Kandidati/ja ka përfunduar Fakultetin _____ dhe merr thirrjen

BACHELOR NË _____

Komisioni:

1. _____ kryetar
2. _____ mentor
3. _____ anëtar

Asistenti/ja administrativ



Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës,
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797
Mail: info@aab-edu.net;
www.aab-edu.net

Nr. 319-1 /2024, Prishtinë, 07/06/2024

Senati i Kolegjit AAB, në mbledhjen e mbajtur më 07/06/2024 mori këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET Rregullorja për procedurën e punimit të temës së diplomës bachelor

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Prorektorëve
2. Sekretarit
3. Dekanëve


Dr.sc. Blerim Olluri, Rektor

